



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 10040 prot.

Tiranë, më 08.11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1620, datë 03.04.2013.

**SHOQËRISË “COEVITA” SH.P.K
Lagjia “Dyli Haxhire”, Rruga “Refik Myftiu”, Elbasan.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Coevita” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1620, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Qafë”, Klos, Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.6432 prot., datë 18.07.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr. 10040 prot., datë 18.07.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1620, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Qafë”, Klos, Elbasan, për shkak se nuk është paguar garancia vjetore e rehabilitimit të mjedisit për vitin 2017 – 2018.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1620, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Qafë”, Klos, Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1620, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Qafë”, Klos, Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI**

**ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI**

ENIS ALIKO

